

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Flora Brovina, figura që ndërthuri poezinë, mjekësinë dhe rezistencën
ADRESA	https://albeu.com/kosove/flora-brovina-figura-qe-nderthuri-poezine-mjekesine-dhe-rezistenca/1012358/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 10:22:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 10:21:54 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f4775bb4c6320f6d150365a4b0a8446875e2f2dffeca2c5d57da8c24fece08a0
TEKSTI	694f025fceabe6f276a8710a58fa2c4ce47e71017ccc07d3aa4e927ddb5236f7
PAMJA	661eaf04c4717d4244f6802d27b322fe36790b29e2a5a86a3f13fe97865832b3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	619bf9c5c03a7e14c6a7df312ed45570b358155a7f6c2d6bcd30859631ea5b16
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0ae22dd21f6bca70f134e59ae1dafa22b8b5d83b679efc36f84697e742e9fc20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/619bf9c5c03a7e14c6a7df312ed45570b358155a7f6c2d6bcd30859631ea5b16>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Flora Brovina, figura që ndërthuri poezinë, mjekësinë dhe rezistencën



Për më shumë se pesë dekada, Flora Brovina bashkoi profesionin e saj me veprimtarinë shoqërore dhe politike. Ajo ishte mjekë pediatre, poete, veprimtare për të drejtat e njeriut, ish-e burgosur politike, veterane e UÇK-së, deputete gjatë gjashtë legjislativave dhe njëra prej nënshkrueseve të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, duke u bërë një nga personalitetet më të njohura të jetës publike, humanitare, kulturore dhe politike në vend.

E lindur më 30 shtator 1949 në Skenderaj, Brovina kreu Fakultetin e Mjekësisë dhe më pas u specializua në pediatri. Një pjesë të specializimit e përfundoi në Zagreb.

Karrierën profesionale e zhvilloi për vite si pediatre, ndër të tjera edhe në repartin e Pediatriisë të Spitalit të Përgjithshëm të Prishtinës. Për rreth nëntë vjet punoi gjithashtu si gazetare e shëndetësisë në gazetën "Rilindja", duke e ndërthurur punën mjekësore me informimin dhe veprimtarinë publike.

Themelimi i Lidhjes së Gruas Shqiptare

Në vitin 1992, kur Kosova ndodhej nën represion të ashpër politik dhe institucional, Flora Brovina themeloi Lidhjen e Gruas Shqiptare.

Kjo organizatë u përqendrua në mbrojtjen e të drejtave të grave, ofrimin e ndihmës humanitare, edukimin në fushën e shëndetësisë dhe fuqizimin e grave.

Brovina ishte edhe mes organizatoreve të protestave paqësore të grave kundër represionit dhe dhunës, përmes të cilave kërkohej respektimi i të drejtave njerëzore dhe kombëtare.

Veprimtaria e saj gjatë luftës në Kosovë

Gjatë viteve të luftës, ajo qëndroi në Kosovë dhe e vijoi punën humanitare e mjekësore në Prishtinë.

të fundit /



Vendimi në Hagë ngre shqetësimet për sigurinë në Kosovë, ekspertët...



Real Madridi përgatitet të ofrojë 87 milionë euro për Adam...



Me të mirët e xhiros së gjashtë në Superligën e Kosovës



Arrestohet në Belgjikë Jasir Avdyli, i dënuar me 12 vite burg në...



Nipi i Jakup Krasniqi: Kosova pret vendimin përfundimtar, historia ...



Përparim Rama për ndarjen nga jeta të Flora Brovinës: Ajo d...



Bedri Hamza për ndarjen nga jeta të Flora Brovinës:...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Në vend që të largohej, Brovina vazhdoi t'u ofronte kujdes grave, fëmijëve dhe familjeve të goditura nga lufta. Në të njëjtën periudhë, ajo drejtoi edhe një strehë të ngritur për gra dhe fëmijë.

Autoritetet serbe e akuzuan se kishte ndihmuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë përmes sigurimit të ushqimit, veshmbathjeve dhe materialeve mjekësore.

Për shkak të veprimtarisë dhe angazhimit të saj në rrethanat e luftës, Brovina njihet gjithashtu si veterane e Luftës së UÇK-së.

Arrestimi dhe burgosja 19-mujore në Serbi

Forcat serbe e arrestuan Flora Brovinën në Prishtinë më 20 prill 1999, ndërsa lufta në Kosovë ende po vazhdonte.

Në fillim ajo u mbajt në Kosovë. Para se forcat ndërkombëtare të hynin në vend, Brovina u dërgua në Serbi së bashku me qindra të burgosur shqiptarë.

Një gjykatë në Nish e dënoi më 9 dhjetor 1999 me 12 vjet burgim. Organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e kritikuan procesin gjyqësor, ndërsa Human Rights Watch evidentoi parregullsi të rënda procedurale.

Më vonë, Gjykata Supreme e Serbisë e anuloi këtë vendim dhe kërkoi që çështja të rigjykohej.

Amnesty International e cilësoi Brovinën "Prisoner of Conscience" dhe nisi një fushatë ndërkombëtare për lirin e saj.

Çështja e saj u diskutua edhe në Parlamentin Evropian, kurse në përpjekjet për lirin e Brovinës u përfshinë institucione dhe organizata ndërkombëtare.

Flora Brovina doli nga burgu më 1 nëntor 2000, pasi kishte kaluar rreth 19 muaj në burg.

Vlerësimet dhe çmimet ndërkombëtare

Veprimtaria e saj tërhoqi vëmendjen e opinionit ndërkombëtar edhe në periudhën kur ajo ndodhej e burgosur.

Swedish PEN e nderoi në vitin 1999 me Tucholsky Prize, një çmim që u kushtojë shkrimtarëve të përndjekur, të kërcënuar ose që jetonin në ekzil.

Në vitin pasues, PEN American Center i akordoi PEN/Barbara Goldsmith Freedom to Write Award, duke vlerësuar angazhimin e saj si mjeke, poete dhe mbrojtëse e të drejtave të njeriut.

Në dhjetor të vitit 2000, Brovina mori në Gjermani një çmim për kurajë qytetare. Në vitin 2001 ajo u përzgjedh mes laureateve të para të Millennium Peace Prize for Women, të organizuar nga UNIFEM në bashkëpunim me International Alert.

Edhe në Kosovë puna e saj u vlerësua me dekorata. Presidentja Atifete Jahjaga i ndau Medaljen Humanitare "Nënë Tereza" në vitin 2012, ndërsa presidenti Hashim Thaçi e dekoroi në vitin 2018 me Medaljen Presidenciale Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë.

Gjashtë legjislatura në Kuvendin e Kosovës

Pas përfundimit të luftës, Brovina e vazhdoi kontributin e saj përmes institucioneve të Kosovës.

Nga viti 2001 deri më 2019, ajo shërbeu pa ndërprerje si deputete e Kuvendit të Kosovës në gjashtë legjislatura.

Mandatin e parë e ushtroi në Legjislaturën I, gjatë viteve 2001–2004.

Në Legjislaturën II ishte deputete nga viti 2004 deri më 2007.

Pjesë e Legjislaturës III ishte gjatë periudhës 2007–2010.

Në Legjislaturën IV shërbeu nga viti 2011 deri më 2014.

Mandati i saj në Legjislaturën V përfshiu vitet 2014–2017.

Në Legjislaturën VI ajo ishte deputete gjatë periudhës 2017–2019.

Një nga ngjarjet kryesore të karrierës së saj politike ndodhi më 17 shkurt 2008. Në cilësinë e deputetes, Flora Brovina u bë njëra prej nënshkrueseve të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës.

Kësisoj, angazhimi i saj publik shtrihej nga rezistenca dhe burgosja në kohën e luftës deri te pjesëmarrja në aktin mbi të cilin u themelua shteti i Kosovës.

Përkushtimi ndaj të drejtave të grave

Një bosht themelor i gjithë veprimtarisë së Brovinës ishte mbrojtja e grave dhe fuqizimi i tyre.

Nëpërmjet Lidhjes së Gruas Shqiptare dhe nismave të tjera, ajo trajtoi çështje që kishin të bënin me të drejtat e grave dhe fëmijëve, arsimin dhe shëndetësinë, përkrahjen e familjeve të goditura nga represioni, fuqizimin ekonomik të grave, dialogun dhe paqen.

Angazhimi i saj përfshiu edhe dokumentimin dhe trajtimin e dhunës së ushtruar ndaj grave gjatë luftës, si dhe përpjekjet për rritjen e pranisë së grave në jetën publike.

Krijimtaria poetike si pjesë e jetës së saj

Krahas kontributit në mjekësi dhe politikë, Flora Brovina zhvilloi një veprimtari të rëndësishme letrare.

Në mesin e veprave të saj poetike renditen "Vërma emrin tim", "Bimë e zë", "Luleborë" dhe "Mat e çmat".

Gruaja, amësia, fëmija, atdheu, liria, lufta, burgu dhe dinjiteti njerëzor ishin ndër temat që zinin hapësirë të rëndësishme në poezinë e saj.

Poezi të përzgjedhura të Brovinës u publikuan edhe në anglisht në përmbledhjen "Call Me by My Name: Poetry from Kosovo", të përkthyer nga albanologu Robert Elsie.

Ajo mbajti edhe postin e kryetares së Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës. Lidhja e saj me këtë organizatë kishte filluar më herët, kur ishte anëtare e kryesisë në periudhën që Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës drejtohej nga Ibrahim Rugova.

Më pas, Brovina mori drejtimin e organizatës dhe u bë përfaqësuese e saj në veprimtari kulturore të zhvilluara në Kosovë dhe jashtë saj.

Rrugëtimi i Flora Brovinës kaloi nga pediatria te krijimtaria poetike, nga veprimtaria humanitare te burgosja dhe më pas te institucionet shtetërore të Kosovës. Në figurën e saj u ndërthurën fusha që rrallë bashkohen te një person i vetëm: mjekësia, humanizmi, letërsia, rezistenca dhe politika.

Shtuar më 15.09.2026 12:21

Tags: [Deputet](#), [Flora Brovina](#), [kosova](#), [vdekje](#)



Vendimi në Hagë ngre shqetësime për sigurinë në Kosovë, ekspertët apeloj...



Nipi i Jakup Krasniqit: Kosova pret vendimin përfundimtar, historia e s...



Përparim Rama për ndarjen nga jeta të Flora Brovinës: Ajo do të jetë pjesë e...



Bedri Hamza për ndarjen nga jeta të Flora Brovinës: Trashëgimi e qëndresës...



Bekteshi: Gjashtë vota mund të vendosin mes presidentit dhe zgjedhje...



Keith Self paralajmëron Hagën: Vendimi për Thaçin të mos ndikohet nga...



Tërmkolli kundërshton retorikën kërcënuese para vendimit të Hagës: Thaçi...



Ndahet nga jeta Flora Brovina në moshën 76-vjeçare



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.